



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 841 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 3034/1, DATË 23.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. DONJET BEQIRAJ”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura të z. Donjet Beqiraj me nr. 1874 prot., datë 12.08.2020 dhe nr. 852 prot., datë 08.04.2022, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve A.Z. P.S. dhe O.L. me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe magjistratit P.V me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në kohën e kryerjes së shkeljeve të pretenduara dhe me vendimin nr. 3034/1, datë 23.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi z. Donjet Beqiraj”, bazuar në nenin 121 , pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ose Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Fier, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Lagjja “16 Prilli”, Rruga “Andon Profka”, Fier;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Konceptoi: Z. Feçi  
Pranoi/Miratoi: E.Kuçi  
2 (dy) kopje, datë 26.03.2024

